



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:084494

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05711135

**C.nr.732/2021**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil**, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridiko-kontestimore të paditëseve G.J., B.M., Sh.D., A.A., A.K., H.V., D.B.M., D.K.O., A.K.R., A.H., J.F., A.M., S.A., S.Gj., V.B., I.P., Sh.M., S.B., G.G., E.Sh., A.H., A.Sh., E.B., D.A.M., S.N., N.K., D.A., M.N.B., E.T.R., S.P.M., A.M., G.D., A.R., G.Sh., Sh.S., L.K., K.K., S.S., R.S., S.K. dhe F.Ç., të cilët me autorizim I përfaqëson av. A.S.K. nga Malisheva, kundër të paditurës (AAPARR) në Prishtinë, adresa MASHT-II, Fakulteti Juridik dhe Ekonomik , për shkak të kompensimit të shujtave ditore dhe udhëtimit, vlera e kontestit 18,9852.66 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëseve si e bazuar. Ndaj të Paditurës - AAPARR.
- II. **DETYROHET** e paditura me kompensimin e shujtës ditore dhe udhëtimit për si në vijim:
  - **G.J.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej : 1354.50 € dhe në emër të në emër të shujtës ditore shumën në vlerë prej 774 €.
  - **B.M.** në emër të udhëtimit Shumën në vlerë prej 541.80 € dhe në emër të shujtës ditore shumën në vlerë prej 774 €.
  - **Sh.D.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej : 203.70 €.
  - **A.A.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 541.80 €.
  - **A.K.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej : 541.80 €.
  - **H.V.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej : 270.90 €.
  - **D.B.M.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej:1083.60 €.
  - **D.K.O.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 1,191.96 €.
  - **A.K.R.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej: 812.70 €.
  - **A.H.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej: 812.70 €.
  - **J.F.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 1,083.60 €.
  - **A.M.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej :812.70 €.
  - **S.A.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej : 541.80 €.
  - **S.Gj.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 270.90 €
  - **V.B.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 270.90 €.
  - **I.P.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 270.90 €.
  - **Sh.M.** në emër të udhëtimit shumën në vlerë prej 270.90 €.

- **S.B.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **G.G.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **E.Sh.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **A.H.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **A.Sh.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **E.B.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **D.A.M.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **S.N.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 203.70 €.
- **N.K.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **D.A.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **M.N.B.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **E.T.R.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **R.G.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **S.P.M.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **A.M.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **G.D.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 228.90 €.
- **A.R.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **G.Sh.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **Sh.S.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **L.K.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **K.K.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **S.S.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **R.S.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej: 135.10 €.
- **S.K.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.
- **F.Ç.** në emër të udhëtimit shumë në vlerë prej 270.90 €.

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 30.04.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit.

- III. DETYROHET** e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 655.00 € (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë euro) në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit G.J., B.M., Sh.D., A.A., A.K., H.V., D.B.M., D.K.O., A.K.R., A.H., J.F., A.M., S.A., S.Gj., V.B., I.P., Sh.M., S.B., G.G., E.Sh., A.H., A.Sh., E.B., D.A.M., S.N., N.K., D.A., M.N.B., E.T.R., S.P.M., A.M., G.D., A.R., G.Sh., Sh.S., L.K., K.K., S.S., R.S., S.K. dhe F.Ç të cilët me autorizim I përfaqëson av. A.S.K. nga Malisheva, pranë kësaj gjykate me datë 30.04.2021 kanë paraqitur padi kundër të paditurës paditurës (AAPARr) në Prishtinë, për shkak të kompensimit të shujtave ditore dhe udhëtimit, vlera e kontestit 18,9852.66 €.

Në padi ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë Qendrës së Kompetencën në Prizren, në pozitën e profesorit. Paditësit G.J. dhe B.M. kërkojnë kompensimin për shujta dhe udhëtim, ndërsa paditësit e tjerë kërkojnë kompensim vetëm për udhëtim. Fillimisht paditësit

me qëllim të ikjes së procedurës gjyqësore i janë drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim sa i përket të drejtave të paditësve, mirëpo e njëjta është përgjigjur se nuk kanë mjete buxhetore të mjaftueshme. Punëtorët udhëtojnë të gjithë për në punë dhe i plotësojnë kushtet e parapara me kontratë kolektive e cila është në fuqi prej datës 18.04.2017, në nenin 35 par.5 dhe par.5 e sipas të cilës punëtorëve iu takon shujta ditore në vlerë prej 2 € në ditë dhe kompensimi i udhëtimit. Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

Me parashtresën e datës 21.09.2022 i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në të cilën ka theksuar se paditësit G.J. për shujta ditore duhet të kompensohet nga data 08.04.2018 e deri me datë 01.12.2021, gjithsej 387 ditë pune e në vlerë totale 774.00 €, ndërsa paditësi B.M. për shujta ditore duhet të kompensohet nga data 29.03.2018 e deri me datë 01.12.2021, gjithsej 387 ditë pune e në vlerë totale 774.00 €. Sa i përket kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për të gjithë përfshihet periudha e kompensimit nga data 08.04.2018 e deri me datë 01.12.2021 për 387 ditë pune dhe të njëjtit duhet të kompensohen 70% të pagesës së biletës së udhëtimit, duke i kërkuar shumat e kompensimit të specifikuara si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% deri. Shpenzimet procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e kërkesës shumën në vlerë prej 80.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, për precizimin shumën në vlerë prej 624.00 €. Për taksë gjyqësore shumën në vlerë prej 31.00.

E paditura (AAPARr) në Prishtinë, në përgjigjen në padi ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në Vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Tutje ka theksuar se paditësit mbështetur në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1 dhe nenit 79 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, në bazë të kësaj paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të ankimit. Sa i përket kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së 13-të, shujtave, shpenzimeve të udhëtimit për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës. E paditura ndaj paditësve të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohej për pagën e 13-të dhe shujta, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare" andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën. Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e paditësve, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 dhe nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësës është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në "Qendrën e Kompetencës" në Prizren, kontestues mbetet fakti se paditësve a i takon kompensimi i shujtave ditore dhe i shpenzimeve të udhëtimit, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, pasi që kërkesa e paditësve gjen mbështetje në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01/B nr.105 dt.22.01.2021.

Gjykata përmes provave – vërtetimeve të cilat paditësit ia kanë bashkangjitur padisë vërtetoi si në vijim:

Nga vërtetimi me nr. prot. 202/2021 vërtetoi se S.A. udhëton nga fsh. Skorobisht për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 211/2021 me të cilin vërtetoi se A.K. udhëton nga fsh. Grejkoc për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 210/2021 me të cilin vërtetoi se A.A. udhëton nga fsh. Korishë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 205/2021 me të cilin vërtetoi se A.H. udhëton nga Suhareka për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 218/2021 me të cilin vërtetoi se J.F. udhëton nga fsh. Peqan për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 223/2021 me të cilin vërtetoi se D.K.O. udhëton nga fsh. Mushtisht për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 214/2021 me të cilin vërtetoi se D.B. udhëton nga Suhareka për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 348 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 220/2021 me të cilin vërtetoi se B.M. udhëton nga fsh. Billushë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 199/2021 me të cilin vërtetoi se G.J. udhëton nga fsh. Senik për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 221/2021 me të cilin vërtetoi se A.M. udhëton nga fsh. Kuk për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 236/2021 me të cilin vërtetoi se A.K. udhëton nga fsh. Zym për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 201/2021 me të cilin vërtetoi se S.K. udhëton nga rr. Dragomanit për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 204/2021 me të cilin vërtetoi se F.C. udhëton nga lagjja Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 65/2021 me të cilin vërtetoi se R.S. udhëton nga lagjja Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 193 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 209/2021 me të cilin vërtetoi se S.S. udhëton nga lagjja Arbana për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 227/2021 me të cilin vërtetoi se K.K. udhëton nga rruga Nashecit për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 224/2021 me të cilin vërtetoi se L.K. udhëton nga rr. Ali Pashë Gucija Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 232/2021 me të cilin vërtetoi se Sh.S. udhëton nga lagjja Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 231/2021 me të cilin vërtetoi se A.R. udhëton nga rr. Ulqini, lagjja Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 234/2021 me të cilin vërtetoi se G.D. udhëton nga rr. Adem Jashari për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 327 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 235/2021 me të cilin vërtetoi se A.M. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 222/2021 me të cilin vërtetoi se S.P. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 206/2021 me të cilin vërtetoi se R.G. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 226/2021 me të cilin vërtetoi se E.T. Rada udhëton nga rr. Shatërvani për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 228/2021 me të cilin vërtetoi se M.N.B. udhëton nga rr. Sozi Qelebi për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 212/2021 me të cilin vërtetoi se D.A. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 208/2021 me të cilin vërtetoi se N.K. udhëton nga rr. Besnik Mucaj për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 99/2021 me të cilin vërtetoi se S.N. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 291 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 217/2021 me të cilin vërtetoi se D.A.M. udhëton nga lagjja Bajram Curri për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 207/2021 me të cilin vërtetoi se E.B. udhëton nga lagjja Petrovë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 216/2021 me të cilin vërtetoi se A.Sh. udhëton nga lagjja e Spitalit për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 225/2021 me të cilin vërtetoi se A.H. udhëton nga rruga Nashecit për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 230/2021 me të cilin vërtetoi se E.Sh. udhëton nga rr. Lekë Matrenga Prizren për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 215/2021 me të cilin vërtetoi se G.G. udhëton nga lagjja Bazhdarhane për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 200/2021 me të cilin vërtetoi se S.B. udhëton nga lagjja Terzi Mahallë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 203/2021 me të cilin vërtetoi se Sh.M. udhëton nga lagjja Ortakoll për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 229/2021 me të cilin vërtetoi se I.P. udhëton nga lagjja Bajram Curri për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 98/2021 me të cilin vërtetoi se Sh.D. udhëton nga lagjja Arbanë për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 291 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 233/2021 me të cilin vërtetoi se H.V. udhëton nga rr. Bajram Curri për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 213/2021 me të cilin vërtetoi se S.Gj. udhëton nga lagjja Bazhdarhane për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 219/2021 me të cilin vërtetoi se V.B. udhëton nga lagjja Arbana për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 237/2021 me të cilin vërtetoi se G.Sh. udhëton nga rr. Jeronim De Rada për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Vërtetimi me nr. prot. 226/2021 me të cilin vërtetoi se E.T.R. udhëton nga rr. Shatërvani për në Jaglenicë dhe anasjelltas dhe punëtori në fjalë për vitin 2018/2019, për vitin 2019/2020 dhe për vitin 2020/2021, i ka gjithsej 387 ditë pune.

Kuponin fiskal lëshuar nga "Xeni Tours" Sh.P.K me përshkrimin Biletë 1 x 0.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T.T.SH "Tosa" me përshkrimin Biletë 1 x 0.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T.T.SH "Tosa" me përshkrimin Biletë 1 x 0.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T.T. "Zhur Tours" me përshkrimin Biletë udhëtimi 1 x 0.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T.SH "Mendi Tours" me përshkrimin Biletë 1 x 0.50€, kuponin fiskal lëshuar nga "Xeni Tours" Sh.P.K me përshkrimin Suharekë - Prizren 1 x 1.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T "Bres Tours" me përshkrimin Biletë 1 x 1.50€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T.SH "Lenti" me përshkrimin Biletë 1 x 1.00€, kuponin fiskal lëshuar nga N.T "Hoxha" me përshkrimin Sh Transport 1 x 1.00€, kuponin fiskal lëshuar nga N.P.Q "Sharri" me përshkrimin Biletë 1 x 1.50€.

Vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e transportit Prizren sipas kërkesës së z.G.J. me të cilin vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Malishevë – Prizren është 5 € në dy drejtime.

Vërtetimet në fjalë, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë

*të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.* Andaj meqë këto dokumente janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, të cilët si të tillë janë të pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e lëshuara nga Drejtori i Shkollës “Qendra e Kompetencës”, në Prizren, si provë me të cilën vërtetohen fakti lidhur me ditët e prezencës në punë dhe realcionet e udhëtimit për secilin paditës gjykata ia fali besimin e plotë, e nga i cilat vërtetoi faktin se paditësit udhëtojnë nga vendbanimi i tyre për në vendin e punës – Jaglenicë, e po ashtu edhe nga kuponët fiskal të lëshuar nga kompanitë turistike të udhëtimit vërtetohet çmimi i biletës për një realcion varësisht nga Qyteti ose Lagjja ku jetojnë paditësit.

Me nenin neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) €, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”.*

Ndërsa me nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 ku është përcaktuar se *“punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*,

Nga provat e cekura si më lartë dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës dhe udhëtimit gjykata erdhi në përfundim se paditësit G.J. dhe B.M. e kanë të drejtën që të kërkojë nga e paditura kompensimin e shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit duke ia njohur të drejtën e shpenzimeve të udhëtimit edhe paditësve tjerë Sh.D., A.A., A.K., H.V., D.B.M., D.K.O., A.K.R., A.H., J.F., A.M., S.A., S.Gj., V.B., I.P., Sh.M., S.B., G.G., E.Sh., A.H., A.Sh., E.B., D.A.M., S.N., N.K., D.A., M.N.B., E.T.R., S.P.M., A.M., G.D., A.r., G.Sh., Sh.S., L.K., K.K., S.S., R.S., S.K. dhe F.Ç., shpenzimet e udhëtimit.

Gjykata nga provat e bashkangjitura padisë gjeti se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë të paditurës Qendra e Kompetencës në Prizren, dhe se paditësit për periudhat për të cilat e kërkojnë kompensimin kanë qenë të pranishëm në punë për ditët e punës të cekura më sipër, fakt ky i i vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga institucioni, ku paditësit punojnë. Duke u nisur nga fakti se e paditura paditësve G.J dhe B.M. nuk i’ka paguar shpenzimet e ushqimit e as të udhëtimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, e paditësve Sh.D., A.A., A.K., H.V., D.B.M., D.K.O., A.K.R., A.H., J.F., A.M., S.A., S.Gj., V.B., I.P., Sh.M., S.B., G.G., E.Sh., A.H., A.Sh., E.B., D.A.M., S.N., N.K., D.A., M.N.B., E.T.R., S.P.M., A.M., G.D., A.r., G.Sh., Sh.S., L.K., K.K., S.S., R.S., S.K. dhe F.Ç., nuk ia ka paguar shpenzimet e udhëtimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit e detyroi të paditurën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje të padisë, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në pikën II të dispozitivit, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (30.04.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 453 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 655.00 € (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë euro), sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 624.00€ dhe taksës gjyqësore shumë prej 31.00 €, përkatësisht shumë e përgjithshme 655.00 €. Ndërsa gjykata vendimin mbi refuzimin e pjesës së shpenzimeve për përpilimin e kërkesës shumë prej 80.00€ dhe për precizim shumë prej 624.00€ e morri në bazë të nenit 453.1 të LPK-së ku përcaktohet se “Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumë e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat.”

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 dhe nenit 398 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
C.nr.732/2021, **21.05.2024**

**B. profesionale**  
**Delvina Ajazaj**

**Gjyqtari**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.



Numri i lëndës: 2021:084494  
Datë: 21.05.2024  
Numri i dokumentit: 05711135